



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada – Government  
Komuna e Drenasit  
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme  
Zyra e Prokurimit  
611-22-12345-2-3-6/C606



## K O N T R A T Ë /SHERBIM

Emri i Projektit: **RIPARIMI I NGROHJEVE QENDRORE NE 13 SHKOLLA**

Numri identifikues: 611-22-099-236 , Datë: 30.11.2022 ; Nr. i arkivit; **400-01/61766**

### PALËT NË MARRËVESHJE

**KOMUNA E DRENASIT** - Drenas, përfaqësuar nga **Gezim Hajdini** Zyrtar i Prokurimit ( më tutje “Punëdhënës”).

**Gafurr Jashari B.I., SHTURBULLOVË,-DRENAS, SHTURBULLOVË, 810255225**, përfaqësuar nga **Gafurr Jashari** , Drejtor (më tutje kontraktuese).

#### Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligjit Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

#### Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **RIPARIMI I NGROHJEVE QENDRORE NE 13 SHKOLLA**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **sherbimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup>. Periudha e kryesjes së punëve/**shërbimeve** dhe furnizimeve do të jetë deri në afatin : **10 dite**.

#### Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **9,719.00 €; [NENTE MIJE E SHTATEQIND E NENTEMBEDHJET EURO ]**

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

#### Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit të projektit, duke mos e tejkaluar shumën prej: **9,719.00 €; [NENTE MIJE E SHTATEQIND E NENTEMBEDHJET EURO ]** Euro.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e

pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktoj me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuuese. Afati i kryerjes së **sherbimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DKA.

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **sherbimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **sherbimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditum ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

## **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i furnizimeve/**shërbimeve**/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

## **Neni 7 Garancioni i shërbimeve**

7.1 Garancioni nuk kerkohet.

## **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [ të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [**shërbimeve**] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

## **Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

## **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

## **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatën e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtuar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim,

korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

**12.1** Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

**13.1** Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.





**13.2** Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

## Neni 14 Komunikimi

**14.1** Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Pjesë e ofertës është paramasa dhe parallogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me **menjehere pas nënshkrimit.**

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	<b>Gezim Hajdini</b>	Emri:	<b>Gafurr Jashari</b>
Pozita:	<b>ZPP</b>	Pozita:	<b>DREJTOR</b>
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	<b>01.12.2023</b>	Data:	<b>01</b>
Vula:		Vula:	

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR KRYERJEN E PUNËVE**  
**Riparimi i nxemjeve qendrore në 13 shkolla**

Pos	Vendi i Punës	Përshkrimi i punës	Njësia	Sasia	Çmimi me tvsh	Vlera (Euro)
1	Shkolla "Gani Sylja" Paktek i RI	Transporti i kalldas më dru 150kV me të gjitha elementët përciellëse të saj, nga depoja e shkollës në Çikatovë të Vjetër deri në deponë e shkollës "Gani Sylja" në Paktek. Në çmim përfshihet ngarkimi, transporti dhe shkarkimi në vendin ku do të montohet.	Copë	1	50.00	50.00
2		Montimi i kalldas (pos 1), pompave qarkulluese, rrjetit të ujit dhe elektrik, si dhe të gjitha elementeve tjera të nevojshme për funksionalizimin normal të kalldas dhe rrjetit të ngrohjes qendrore në shkollë. Në këtë çmim përfshihet servisi i këtyre pajisjeve nëse kanë defekte, furnizimi me elementet që mungojnë, shkarkimi i rrjetit për nëvoja të punimeve në rrjet, ngarkimi i rrjetit pas përfundimit të punimeve, funksionalizimi i kalldas me të gjitha elementet përciellëse dhe testimi i rrjetit pas përfundimit të punimeve.	Copë	1	2,000.00	2,000.00
3		Furnizimi dhe montimi i oxhakut nga kalldaja me dru deri mbi kulmin e depos. Në çmim përfshihen të gjitha elementet deri në funksionalizim.	Copë	1	600.00	600.00
4		Furnizimi, shtrirja, përforcimi dhe lidhja e gypit të zi nga çeliku, Ø50mm nga rrjeti kryesor ekzistues i nxemjës në shkollë e deri të kalldaja që do të vendosët në depo(bashkangjit me objektin e shkollës). Në çmim përfshihen edhe lidhja me saldim e këtij gypi me gypin kryesor, përforcimi i gypit në mure dhe pllakë, si dhe distancë të nevojshme, depertimet e gypit në mure dhe pllakë, si dhe lidhja me kalldan e re. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për shtrirjen, lidhjen dhe funksionalizimin e këtij rrjeti gypor nga kalldaja deri në rrjetin e vjetër.	m'	60	14.00	840.00
5		Furnizimi, shtrirja, montimi dhe lidhja e kabllit 3x2.5mm <sup>2</sup> se bashku me murojën plastike, duke filluar nga kutia e siguresave e deri të pompat qarkulluese të kalldasë së nxemjës qendrore në depo(bashkangjit me objektin e shkollës). Në çmim përfshihen edhe vendosja e siguresës përkatëse, lidhja-përforcimi i burojes në mure të shkollës, depertimet në mure dhe pllakë, si dhe elemente e nevojshme për lidhje me pompat qarkulluese. Në çmim përfshihen të gjitha punët dhe materialet e nevojshme për shtrirjen, lidhjen dhe funksionalizimin e këtij rrjeti.	m'	25	3.00	75.00
6		Pastrimi i kalldas së vjetër të kësaj shkollë dhe oxhakut.	Copë	1	100.00	100.00
7	Sipas nevojës	Rregullimi i kalldas së ngrohjes qendrore në shkollat e komunës së Drenasit. Në rregullim të kalldas përfshihet, identifikimi i defektit dhe mënjanimi i defektit që shfaqet në kallda, në pompa qarkulluese, në sistemin e elektrikut të kalldas dhe kudo në elemente tjera përciellëse.	copë	1	450.00	450.00
8	Shkolla në Baitë	Evitimi i rrjedhjeve në kalldan e nxemjës qendrore në shkollën e Baitës (kalldaja me dru 500Kvat). Fillimisht duhet të identifikohen të gjitha rrjedhjet në pjesën e pasme të kalldas, e cila është e ndryshkur dhe pastaj të mbyllen rrjedhjet me saldim (foton 1). Kalldaja është nga materiali gus. Në çmim duhet të përfshihet edhe blerja dhe montimi i ventilit sigures mbi këtë kallda (foton 2). Ventili duhet të jetë 1 coll dhe të rezistojë presionit 3 bar. Për të mundësuar saldimin në çmim përfshihet edhe shkarkimi (derdhja) i rrjetit që është me uji dhe ngarkimi i rrjetit me uji pas përfundimit të punimeve.	copë	1	250.00	250.00
9	Shkolla në Polluzhë	Evitimi i 4 rrjedhjeve në gypat e nxemjës qendrore në shkollën e Polluzhës. Rrjedhjet duhet të evitohen përmes saldimit të vrimave në gypat e ngrohjes që janë nga çeliku i zi. Për të kryer saldimin efektiv, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	copë	1	200.00	200.00
10	Shkolla në Gilanasellë	Evitimi i 5 rrjedhjeve në gypat e nxemjës qendrore dhe 2 rrjedhje në radiator në shkollën e Gilanasellës. Rrjedhjet duhet të evitohen përmes saldimit të vrimave në gypat e çelikut e në radiator të ngrohjes. Në çmim përfshihet edhe furnizimi dhe montimi i një ventili për radiator, si në foto. Për të kryer saldimin efektiv, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	copë	1	250.00	250.00
11		Furnizimi dhe montimi i rregullatorit të temperaturës në kalldan me dru 200Kvat, se bashku me zgjngjir.	copë	1	40.00	40.00


12	Shkolla në shtuteci	Evitimi i rrjedhjës në ventillin kryesor në dalje të kalldas. Evitimi i rrjedhjës mund të bëhet me vendosjen e diktuneve ose ndrrimin e ventillit me elemente përciellëse (foto).	copë	1	50.00	50.00
13		Evitimi i 3 rrjedhjeve në gypat e nxëmjes qëndrore në shkollë. Rrjedhjet duhet të evitohen përmes saldimit të vrimave në gypat e ngrohjes që janë nga çeliku i zi. Për të kryer salldimin efektiv, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	copë	1	150.00	150.00
14	Shkolla e Gllobarrit	Furnizimi dhe montimi i 4 ventillave të ajrosjes. Një ventill është mbi kalldan më dru, një mbi enë dhe dy ventilla në pikën më të lartë të rrjetit. Ventilati duhet të jenë të njëjtë më ata ekzistues. Shiko fotot.	copë	1	95.00	95.00
15	Shkolla në Fushitë të Poshtme	Furnizimi dhe montimi i ornatësit të temperaturës së kalldas me dru në shkollën e Fushticës së Poshtme, shiko foton	Copë	1	50.00	50.00
16		Furnizimi dhe montimi i radiatorit 22/60/100cm në nje sanitare, me të gjitha elementet e nevojshme, përfshirë mbajtësit, ventillat hyrje dalje. Në çmim përfshihet edhe zgjatja për 1 m e dy gypave ekzistues Ø20mm për furnizim të këtij radiatorit, pasi që vendi i radiatorit do të çvendoset për 1 metër (shiko foton). Gjithashtu të llogaritet edhe shpimi i murit me trashësi 15cm dhe diamter Ø20mm në dy vende për kalimin e gypave. Për kryerjen e këtyre punëve, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	copë	2	135.00	270.00
17	Shkolla në Dobroshec	Furnizimi dhe montimi i një radiatorit me dim 22/60/140cm, me të gjitha elementet përciellëse, përfshirë ventillat për hyrje-dalje në radiator. Në koridorin e aneksit të vjetër të shkollës do të shtohet një radiator i ri, në afersi të gypave të furnizimit me ngrohje(uji). Për lidhjen e radiatorit me rrjet furnizues, janë të nevojshëm edhe gypat vertikal nga çeliku i zi dhe lidhja e tyre me gypat furnizues përmes saldimit.	Komplet	1	250.00	250.00
18		Furnizimi me material dhe lidhja e dy gypave Ø36mm të rrjetit të ngrohjes qëndrore në shkollë (shiko foton). Lidhja të bëhet me saldimit. Në Çmim të përfshihet prerja dhe largimi i pjesës së dëmtuar, si dhe furnizimi dhe montimi me saldimit i dy gypave të ri nga çeliku i zi, më gjatësi rreth 70cm. Për kryerjen e këtyre punëve, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	Komplet	1	180.00	180.00
19	Shkolla në Kishnarek	Furnizimi dhe montimi i pompës qarkulluese DN 100/100 për kalldan e ngrohjes qëndrore në shkollën e Kishnarekës.	copë	1	1,499.00	1,499.00
20	Shkolla në Verboc	Furnizimi dhe montimi i ventillave sigurues në dalje të radiatorit të ngrohjes qëndrore në shkollë, të cilët rrjedhin. Shiko foton.	Copë	5	20.00	100.00
21		Furnizimi dhe montimi i rregullatorit të shpejtësisë së pompës qarkulluese të kalldaja me dru. Pompa qarkulluese punën vetëm në shpejtësin nr. 3 (nuk punon në shpejtësin 1 e as 2), shiko foton. Në çmim përfshihet rregullimi i punës së pompës qarkulluese në tri shpejtësi, më ndrim të pjesës apo pa ndrim.	Copë	1	200.00	200.00
22		Furnizimi me ventilla për hyrje dalje në radiator dhe montimi i radiatorëve tip 22/60/60cm në nje sanitare të shkollës.	Copë	4	60.00	240.00

23	Qerdhja në Drenas	Furnizimi dhe montimi i ventillave sigurues në dalje të radiatorit të ngrohjes qëndrore në qerdhe, të cilët rrjedhin, si dhe ç'montimi i ventillit të vjetër, shiko foton.	Copë	6	18.00	108.00
24		Evitimi i tri rrjedhjeve në gypat e nxëmjes qëndrore në qerdhe. Rrjedhjet duhet të evitohen përmes saldimit të vrimave në gypat e ngrohjes që janë nga çeliku i zi. Për të kryer salldimin efektiv, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më uji dhe ngarkimin e tij prap me uji pas përfundimit të punimeve.	Komplet	1	140.00	140.00
25		Furnizimi dhe montimi i radiatorit tip 22/60/180cm në klasën e vogël të qerdhes, me të gjitha elementet e nevojshme, përfshirë mbajtësit, ventillat hyrje dalje. Në çmim përfshihet edhe ç'montimi i radiatorit ekzistues së bashku me komizën dekorative nga druri.	Copë	1	200.00	200.00
26	Qerdhja Komoran	Furnizimi dhe montimi i ventillave sigurues në dalje të radiatorit të ngrohjes qëndrore në qerdhe, të cilët rrjedhin. Shiko foton.	Copë	4	18.00	72.00
27		Evitimi i 3 rrjedhjeve në gypat e nxëmjes qëndrore në qerdhe. Rrjedhjet duhet të evitohen përmes saldimit të vrimave në gypat e ngrohjes që janë nga çeliku i zi. Për të kryer salldimin efektiv, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më uji dhe ngarkimin e tij prap me uji pas përfundimit të punimeve.	Komplet	1	100.00	100.00
28	Terstenik	Furnizimi dhe montimi i radiatorit tip 33/30/120cm në koridor të shkollës, me të gjitha elementet e nevojshme, përfshirë mbajtësit, ventillat hyrje dalje. Në çmim përfshihet edhe ç'montimi i radiatorit ekzistues. Për kryerjen e këtyre punëve, punëkryesi duhet të bejë edhe shkarkimin e rrjetit që është më antifriz dhe ngarkimin e tij pas përfundimit të punimeve.	Copë	2	140.00	280.00
29		Furnizimi dhe montimi i mbulesës së oxhakut të ngrohjes qëndrore të shkollës nga llamarina e zjetuar. Oxhaku ka dimensione 1.20x1.0(m').	Copë	1	280.00	280.00
30		Servisimi - evitimi i defektit të korrektorit të rrymës elektrike, i cili përforconë rrymën për pompa qarkulluese dhe për pajisje të shkollës. Nëse nuk mund të evitohet defekti, atëherë më këtë çmim operatori duhet të furnizoj shkollën me korrektor të ngjashëm.	Copë	1	600.00	600.00
<b>Totali i vlerës së tenderit me tvsh:</b>						<b>9,719.00</b>

Plani dinamik: 10ditë punë, përveç pozicioni 7 kryhet kurdo që paraqitet nevoja në periudhën deri me 20.12.2022

<i>Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)</i>	
Emri i OE:	<b>GAFURR JASHARI B.I</b>
Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit të OE:	<b>GAFURR JASHARI</b>
Nenshkrimi dhe vula:	
Data:	<b>14.11.2022</b>









**Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate**

**Seria** | 10000530483

Për

KOMUNA GLOGOC

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

**DUKE PASUR PARASYSH QË**

N.P.Sh. " Doni Term "

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

RIPARIMI I NGROHJEVE QENDRORE NE 13 SHKOLLA

të dhënë me numrin e Prokurimit

611-22-12345-2-3-6/C606

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

971.90 €

Nëntë Qind e Shtatëdhjetë e Një Euro e Nëntëdhjetë Cent

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju paguajmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoriteti kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Oferitë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumat brenda limiteve të

971.90 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

01.12.2022

deri më

31.01.2023

Lëshuar në

Prishtinë

datë

01.12.2022

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË

